

Numri: 05 ~ 09/2016



# Balkan PERSPECTIVES

*Revistë për ballafaqimin me të kaluarën*

**NJË DJALË I RI PËR  
BARAZINË GJINORE**

09

**PAQJA E PABARABARTË**

18

**Historia e saj dhe e tij**

03. KRYEARTIKULL

04. VOX POP

06. PËRBALLJA ME TË ARDHMEN:  
NDRYSHIMI I QËNDRIMIT NDAJ  
TË SHKUARËS

09. NJË DJALË I RI PËR BARAZINË  
GJINORE

12. SILLU SI BURRË!

14. TË MBIJETUARAT KËRKOJNË TË  
DREJTAT E TYRE!

ZHDËMTIM PËR TË MBIJETUARAT  
E DHUNËS SEKSUALE NGA  
KONFLIKTI NË KOSOVË 16.

PAQJA E PABARABARTË 18.

LE TË (MOS) FLASIM PËR SEKsin:  
REFLEKTIME RRETH TABUVE  
GJINORE NË GJUHËN SHQIPE 20.

LAJME DHE PËRDITËSIME 23.

IMPRESSUM 24.





# KRYE- ARTIKULL

*Prishtinë, gusht  
2016*

Të dashur Lexues,

**P**o takohemi sërish në numrin e pestë të revistës *Balkan.Perspectives* nga forumZFD që merret me ballafaqimin me të kaluarën. Ky numër i kushtohet temës së gjinisë dhe shtjellon pse gjinia ka rëndësi në procesin e ballafaqimit me të kaluarën.

Kur flasim për ballafaqimin me të kaluarën në Ballkanin Perëndimor, respektimi i gjinisë zakonisht nënkupton vetëm diskutime dhe ato vetëm për dhunën seksuale kundër grave gjatë kohës së luftërave. Për rrjedhojë, gratë nuk shihen si agjente të ndryshimit; kështu, ato nuk përfshihen kur bëhen përpjekje për të tejkaluar të shkuarën e dhunshme dhe për të rindërtuar një shoqëri paqësore.

Qëllimi i diskutimit tonë sot nuk synon të përjashtojë diskutimin për dhunën seksuale kundër grave gjatë luftës apo pasojat e asaj dhune. Ne shpresojmë të zgjerojmë kuadrin dhe të diskutojmë edhe për aspekte të tjera të barazisë gjinore gjatë procesit të ballafaqimit me të kaluarën.

Në kryeartikullin tonë, Marina Blagojeviq paraqet argumente për një qasje feministe gjatë ballafaqimit me të kaluarën dhe për krijimin e njohurive pozitive dhe shëruese për (ri) ndërtimin e shoqërisë.

Po ashtu, Besnik Leka (i intervistuari ynë) dhe Vojislav Arsiq, që të dy të përkushtuar për të punuar me burrat për barazinë gjinore, konsiderojnë se përfshirja e djemve të rinj në proceset që kanë të bëjnë me barazinë gjinore është me rëndësi kyçe për krijimin e një shoqërie të qëndrueshme.

Ashtu si burrat nuk duhet të përjashtohen nga puna për barazinë gjinore, edhe Nela

Porobiq Isaković shkruan në artikullin e saj mbi organizatën Gratë Organizohen për Ndryshim në Siri dhe në Bosnje e Hercegovinë argumenton se gratë duhet të përfshihen në proceset e paqes. Duke bartur njohuritë dhe përvojat nga Bosnja e Hercegovina në Siri, organizatorët shpresojnë të krijojnë aleanca më të fuqishme që përfshijnë gratë në proceset e ndërtimit të paqes.

Duke qenë se gjuha krijon dhe ndikon realitetet tona, Bukurie Mustafa shtjellon se si pasqyrohen në gjuhën shqipe marrëdhëniet dhe tabutë gjinore në hapësirat intime dhe si duhet të konsiderohen tabutë dhe vlerat e tilla kur mendojmë të bëjmë ndryshime.

Gratë në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftërave të viteve 1990. Në këtë numër të revistës, dy artikuj përshkruajnë se si të mbijetuarat ballafaqohen me të kaluarën e tyre. Nita Gojani dhe Siobhan Hobbs nga UN Women në Kosovë përshkruajnë gjendjen aktuale të gjinisë dhe ballafaqimit me të kaluarën dhe sfidat që kanë ende të mbijetuarat. Selma Korjeniq nga TRIAL Bosnia ndan përvojat e saj nga puna me të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe avokimi për kompensim dhe njohje.

Ashtu si në numrat e kaluar të *Balkan.Perspectives*, ka dhe aspekte të tjera që do të mund të ishin shtuar apo thënë. Mirëpo sot kam kënaqësinë të ndaj me ju numrin tonë të pestë të revistës si një hap drejt një rrugëtimi të gjatë që do të krijojë më shumë njohuri për gjininë dhe si gjinia lidhet thellë me ballafaqimin me të kaluarën.

Sinqerisht,  
*Maike Dafeld / Kryeredaktore*

# Ç'ËSHTË BARAZIA GJINORE PËR JU?



## BOSNIA E HERZEGOVINA

Për mua, do të thotë se ka po aq mundësi që Zoti të jetë grua. Është marrëzi edhe të mendosh se burrat janë më kompetentë se gratë.

**Dario N.S. , 30**

“Për mua, barazia gjinore nënkupton një shoqëri me mundësi të përbashkëta dhe të barabarta për të gjithë, pavarësisht përkatësisë së tyre gjinore. Një shoqëri, ku gjinia e dikujt nuk përcakton statusin, mundësitë për punësim apo nivelin e pagës.”

**Denis P., 26**

Edhe pse nuk e konsideroj veten aspak feministe, jam e vetëdijshme se jeta e gruas ka qenë më shumë gjak se sa mjaltë përgjatë historisë. Sot, e quaj veten me fat që kam mundësi të punoj, të votoj dhe të jem në gjendje të zgjedh se a do të kem fëmijë a jo dhe me kë do t'i kem ata fëmijë. Dhe jam me shumë fat që kam një shok, i cili është vetëm shok, aspak superior. Nuk jam e sigurtë nëse e kuptoj saktë përkufizimin e barazisë gjinore, por jam e sigurtë se nuk ekziston në gjysmën e planetit tonë. Atëherë, çfarë do të thotë barazia gjinore për mua? Në radhë të parë, vetë fakti që po ma bëni këtë pyetje. Dhe aftësia që t'i jap përgjigje në anglisht si vajzë boshnjake.

**Irena P. 33 years**

## SERBIA

“Barazia gjinore është një dukuri që duhet të ekzistojë kudo në botë. Për momentin, nuk është e pranishme jo vetëm në disa vende islamike, por as në Evropë apo vende perëndimore. Mendoj se po imponohet artificialisht; një ide e tillë ende nuk është mishëruar nga gratë dhe burrat në shkallë globale.”

**Ana J., 30**

“Barazi gjinore do të thotë kur të gjitha të drejtat e njeriut zbatohen njëjtë për të dy gjinitë dhe kur burrat dhe gratë kanë ndikim të barabartë në politikë, shkencë, arsim dhe të gjitha sferat e tjera të jetës.”

**Gjorgje Gj., 32**

“Barazi gjinore do të thotë paga të barabarta për burra dhe gra që bëjnë të njëjtën punë. Ndërgjegjësimi për pozitën shoqërore të grave është mbajtur në nivel primitiv për shekuj dhe nuk mendoj se mund të ndryshohet vetëm përmes arsimit. Nëse gratë do të kishin mundësinë të jenë po aq të pavarura sa edhe burrat, mendoj se kjo do të kishte patur ndikim tek pikëpamjet e njerëzve dhe se burrat dhe gratë më në fund do të trajtoheshin njësoj – si njerëz. Vendet skandinave janë një shembull pozitiv.”

**Anja M., 31**

## KOSOVA

“Barazia gjinore është parim i të drejtave të njeriut dhe parakusht për një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë. Ne duhet t'i ndryshojmë pengesat historike dhe shoqërore ndaj grave. Pabarazia sistematike ndërmjet burrave dhe grave ekziston në mbarë botën. Barazia gjinore është mjet i pazëvendësueshëm për të avancuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të zbutur varfërinë përmes qasjes së barabartë në burime, si dhe është mundësi dhe për t'iu dhënë zë në proceset vendimmarrëse që formësojnë shoqërinë.”

**Rozafa K., 28**

“Barazia gjinore inkurajon përfshirjen e barabartë të burrave dhe grave në familje si dhe në sferat socio-ekonomike dhe politike. Është me rëndësi që burrave dhe grave t'u jepen mundësi të barabarta për të bërë të mundur ndryshimet shoqërore. Këto mundësi mund të përdoren në mënyrë të barbartë vetëm atëherë kur edhe përgjegjësitë janë ndarë në mënyrë të barabartë. Prandaj, për t'i përfshirë gratë në vendimmarrje, në jetën profesionale dhe institucionale në mënyrën më efektive, burrat duhet të përfshihen më shumë në jetën familjare.”

**Kadri G., 32**

“Barazia gjinore është barazia e mundësive në të gjitha sferat e jetës. Ajo nënkupton respektimin e nevojave, vlerave dhe aspiratave të grave dhe burrave në mënyrë të njëjtë.”

**Linda B., 40**

## MAQEDONIA

Për mua, barazia gjinore është një situatë ku asnjë person, nga cilado gjini, nuk ndjehet se meriton më shumë të drejta se tjetri.

**Elham B., 29**

Barazia gjinore është kur gratë nuk kanë frikë të enden rrugëve vetëm, ditën apo natën; kur mendjen e tyre e respektojnë më shumë se sa trupin. Barazia gjinore është kur burrat i bëjnë të gjitha punët e shtëpisë pa i vënë në lojë askush dhe kur ata mund të bëhen balerinë, të qajnë apo të shfaqin emocione në publik pa i fyer askush.

**Angela M., 23**

Për mua personalisht, barazia gjinore është RESPEKTI në të gjitha mënyrat. Për shembull, nëse duhen 100\$ për një punë, atëherë askujt nuk duhet t'i interesojë nëse punën e ka bërë një grua apo një burrë. Në këtë rast, duhet të respektohet rezultati dhe të jepen ato 100\$ dhe jo të jepen 75\$, sepse punën e ka kryer një person i gjinisë tjetër.

**Danijela Z., 23**

# Përballja me të ardhmen: ndryshimi — i qëndrimit ndaj të shkuarës

*Perspektiva gjinore në ballafaqimin me të kaluarën është jo vetëm element “i mirë për t’u pasur”, por edhe i rëndësishëm kyçe për të krijuar një të ardhme të ndryshme. Marina Hjuson paraqet argumente se një ndërhyrje feministe do t’i kontribuonte krijimit të një shoqërie të qëndrueshme dhe paqësore.*

A janë të ndërlidhura e ardhmja dhe e kaluara dhe nëse po, në ç’mënyrë? Kjo është një pyetje aq e thjeshtë, sa të gjithë e kanë nga një përgjigje “të qartë” për të, që rrjedh nga përditshmëria e tyre: “Sigurisht që janë të ndërlidhura; ajo që bëj sot më çon tek pasojat e nesërme”. Mirëpo pikërisht kjo “qartësi” nuk është dhe aq e thjeshtë. Sepse ajo që bëjmë sot është në thelb e kushtëzuar nga ajo që dëshirojmë të jemi, të arrijmë – nesër.

Atëherë, pse kjo logjikë kaq e thjeshtë e dëshirave, shpresave, pritshmërive pozitive nuk është thjesht e transferueshme tek kolektiviteti të cilit i përkasim? Përse na tremb e ardhmja kolektive,

pavarësisht a është e rajonit, Evropës apo botës, edhe kur e ardhmja jonë personale duket mjaft interesante dhe tërheqëse? Çfarë i atribuojmë të ardhmes kolektive duke lënë kështu jashtë tonës? Si përfundim, përse mendojmë se mund të ndikojmë tek e ardhmja jonë personale apo së paku që mund ta ndikojmë atë më shumë se sa mund ta ndikojmë të ardhmen kolektive? Duke folur në përgjithësi, përse e kaluara duhet të ketë rëndësi për të ardhmen, të jetë më e rëndësishme se sa ajo që lejojmë? Si mund të përballemi me të ardhmen të cilën e kemi frikë, meqë jemi të shenjuar nga plagët e së kaluarës?

## Perspektiva gjinore në pajtim

Deri në dhjetëvjeçarin e fundit, gratë kanë qenë kryesisht të padukshme, qoftë si viktime specifike të luftës apo si paqebërëse. Interesi për hulumtime feministe po rritet. Falë kësaj vetëdijeje të re, relevanca e aspekteve specifike dhe me bazë gjinore në konflikte, ashtu si dhe pajtimi, kanë fituar më shumë vëmendje. Ekziston edhe një ndryshim i dukshëm nga perceptimi në thelb se gratë janë “paqebërëse të natyrshme” drejt një ekzaminimi më kritik të pozicioneve të ndryshme të



grave dhe burrave lidhur me luftën. Si gratë, ashtu edhe burrat mund të jenë viktimat, luftëtarë ose paqebërës. Shifrat apo përqindjet nuk mund të jenë tregues realë të “natyrës së vërtetë” të gruas apo të burrit. Aktualisht, ato mund të jenë vetëm pika e nisjes për një analizë të kushtëzimit social dhe konstruktit kulturor të gjinive si të tilla. Politikat me perspektivë gjinore nga vetë natyra e tyre theksojnë dallimet mes grave dhe burrave, por këto dallime nuk duhet të merren si të palëvizshme, “natyrore” apo të pandryshueshme.

Megjithatë, perspektiva gjinore për të cilën avokoj këtu shkon përtej perspektivës së zakonshme gjinore që fillimisht zbatohet në raste të analizës së pasojave dhe të përballjes me të kaluarën. Përkatësisht, do të doja të pretendoja se ndërhyrja femine në vetë njohuritë, në njohuritë për luftën, por edhe njohuritë për pajtim, mund të ndryshojnë jo vetëm perceptimin e së kaluarës, por edhe të ndikojnë në krijimin e një të ardhmeje ndryshe.

Një perceptim i ndryshëm i të kaluarës, njohuri të ndryshme dhe të kuptuarit e të kaluarës nuk nënkuptojnë se konflikti dhe faktet që kanë të bëjnë me viktimat duhet të fshihen apo të minimizohen. Ai do të thotë se këtyre fakteve duhet t’u shtohen të tjerë, si për shembull fakte që kanë të bëjnë me bashkëpunimin, asistencën e ndërsjellë, solidaritetin dhe rezistencën ndaj luftërave. Përveç “historisë negative” është me rëndësi që të shkruhet edhe për “historinë pozitive” në mënyrë që pasqyra të jetë e plotë dhe të bëjë të mundur jo vetëm të kuptuarit më të mirë të dinamikave të luftës, por edhe të shërimit dhe shpresës. Vetëm krijimi pa paragjykime i të kaluarës, që përfshin edhe historinë pozitive, e bën të mundur krijimin e një të ardhmeje pa konflikte. Këmbëngulja tek “historia pozitive” si një tjetër anë e historisë dërgon mesazhe për mundësinë e zgjedhjeve, që bëhen nga secili individ apo grup, nga e para.

Historia nuk është diçka e detyruar, por është aktivitet njerëzor. Ajo nuk i nënshtrohet ligjeve të natyrës, por është pasojë e një sërë zgjedhjesh. Kjo do të thotë se secili akter social, individ ose grup, ka përgjegjësi, meqë ka edhe përgjegjësinë për të zgjedhur. Kjo zgjedhje kufizohet nga fuqia dhe pozicioni i tyre në komunitet, por një zgjedhje e tillë gjithnjë ekziston. Prandaj, vetëm të kuptuarit e historisë si zgjedhje mund të sjellë të kuptuarin e përgjegjësisë si individ. Pasi nëse nuk ka zgjedhje, nuk ka as përgjegjësi. Nëse historia është një rrjedhë e pashmangshme ku gjithnjë ndodhin konflikte, atëherë e ardhmja është e pashpresë dhe akterët individualë dhe kolektivë janë thjesht objekte të “forcës së rëndësës historike”.

Qasja femine, si një lexim konsistent i trashëgimisë teorike femine e sheh shkencën, madje edhe shkencën historike, si androcentrike dhe “të prirur” drejt anës mashkullore. E sheh si një konstrukt të krijuar nga ata që janë në pushtet (“historia shkruhet nga fitimtarët”) në mënyrë që t’i ndihmojë ata të fitojnë dhe ta mbajnë pushtetin. Ajo që mbetet e përjashtuar, jashtë apo e marginalizuar në narrativën dominuese të mbështetur nga njohuria androcentrike është pikërisht ajo që shpalos qasjen femine ndaj njohurisë dhe e bën atë të dukshme.

Pajtimi nuk mund të mbështetet tek njohuria, bazë e të cilit është ideja e historisë si dominim dhe konflikt. Në të njëjtën mënyrë që luftërat ishin “profeci vetë-përmbushëse”, pajtimi është i mundur vetëm si një “profeci vetë-përmbushëse”, si diçka që thërritet, prodhohet dhe rezulton nga një matricë e njohurisë krejtësisht e ndryshme nga ajo që ka prodhuar luftërat. Pajtimi është i pamundur nëse nuk krijohet një “meta-narrativë” për jetesën e përbashkët, shkëmbimin, solidaritetin dhe bashkëpunimin, që do ta bënte të mundur përfshirjen e përvojave të ndryshme individuale që i rezistojnë narrativës dominuese për pashmangshmërinë e konfliktit.

Mësimet kryesore për projektin e njohurisë që do të krijohet për përballjen me të kaluarën që të prodhojë të ardhmen e dëshiruar pa konflikte do të ishin këto në vijim:

- Është e nevojshme që të tejkalohet esencializmi (“gratë e duan paqen”, “burrat janë agresivë”);
- Është e nevojshme të dekonstruktohen dhe të pozicionohen “njohësit”, ata që prodhojnë njohuri, në mënyrë që të kuptohen produktet e tyre nga perspektiva e pozicioneve të pushtetit që mbajnë;
- Është e nevojshme të rritet vetëdijësimi rreth pozicionit të atyre që punojnë për pajtimin, meqë vetëm vetëreflektimi dhe vetëdijësimi i rritur i pozicionit të tyre, përfshirë dhe dekonstruktimin e privilegjeve të veta është kërkesë për qasje objektive dhe efektive;
- Duhet të bëhet i mundur krijimi i një meta-narrative për pajtimin që patjetër duhet të mbështetet jo vetëm tek “drejtësia për viktimat”, por edhe “historia pozitive”;
- Duhet të kuptohet se njohuria është konstrukt që pasqyron sistemin patriarkal;
- Është e nevojshme të zbulohen “pikat e paqarta” që

janë të ndërlidhura ngushtë me pafuqinë gjatë luftës; është e nevojshme që të shpalosen të gjithë ata që kanë pushtet, pavarësisht fushës apo pozicioni social prej nga vijnë;

- Është e nevojshme të afirmohet perspektiva “nga poshtë-lart”, perspektiva e jetës së përditshme (historia sociale) përkundër perspektivës lartë-poshtë (historia politike);
- Është e nevojshme të kuptohet se veprimet individuale janë të ndërlidhura ngushtë me hierarkitë sociale dhe pushtetin;
- Është e nevojshme të avokohet njohuria që do të kishte pushtet shërues dhe pajtues, se sa fuqia e krijimit të konflikteve dhe keqkuptimeve.

### **Njohuri shëruese: “historia pozitive”**

Për shkencëtarin e orientuar nga feminizmi, sfida e vërtetë qëndron në pyetjen se si të krijojë njohuri që në vetvete janë pjesë e procesit të pajtimit, në vend se të jetë pjesë e konfrontimeve të reja. Pra, nuk është “vetëm” për të treguar vuajtjet dhe viktimat, por më shumë për të krijuar “njohuri si pajtim”, për të krijuar njohuri që do të kenë fuqinë të shërojnë duke shpalosur pafuqinë në shumë nivele të ndryshme, me shumë akterë të konfliktit, në nivel mikro dhe makro. “Historia pozitive” mund të jetë projekt për njohuri feministe shëruese.

Në rastin e ish-Jugosllavisë, historia e “jetesës së përbashkët” ka zgjatur më shumë se historia e konflikteve. Pasqyra e realitetit do të ishte shumë e shtrembëruar nëse të gjitha konfliktet do të merreshin si “histori” dhe jo edhe si pjesë e ndërlidhur me “jetesën e përbashkët”. Përveç gjithë kësaj, nëse mbizotëron interpretimi që thekson vetëm historinë e konflikteve, ai faktikisht u jep më shumë fuqi. Ekziston një marrëdhënie e ngushtë dhe qarkore ndërmjet interpretimit dhe rezultateve specifike në realitet. Nëse historia interpretohet si histori e konflikteve të përjetshme, konflikte të pashmangshme që përsëriten rregullisht, me vetëm disa “shpërthime të paqes” të shkurtra dhe jo relevante, akterët shoqërorë përballen atëherë me mungesën e zgjedhjeve të vërteta. Në një rast të tillë, “historia negative” shndërrohet në fatin e tyre dhe e ardhmja zhduket.



**Marina Blagojeviq** është sociologe serbe, studiuese e çështjeve gjinore, eksperte e çështjeve gjinore dhe feministe. Në vitin 1991, bashkë me pjesëtare të tjera të grupit të aktivisteve feministe “Gratë dhe shoqëria”, Blagojeviq bashkë-themloi dhe shërbeu në bordin e parë të Qendrës për Studime të Grave në Beograd, Jugosllavi. Puna e saj si eksperte ndërkombëtare për çështje gjinore e ka çuar atë në organizata të ndryshme, si Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, UN Women, Sida dhe Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim të Bujqësisë. Ajo ka botuar më shumë se 100 botime akademike dhe 20 ekspertiza.





*Besnik Leka promovon barazinë gjinore në Kosovë. Në intervistën tonë ai shpalos pse barazia gjinore lidhet ngushtë me ballafaqimin me të kaluarën. Po ashtu, ai ndan me ne motivimin për punën e tij të përditshme.*

# Një djalë i ri për barazinë gjinore

## Ç'është për ju barazia gjinore?

Perceptimi i barazisë gjinore ka evoluar me kalimin e viteve. Ka raste kur, për fat të keq, ai keqinterpretohet dhe keqkuptohet. Shumë njerëz në ditët e sotme e ngatërrojnë barazinë gjinore me fuqizimin e njëres gjini ndaj tjetrës. Një nga arsyt kryesore për këtë keqkuptim është fakti se numri i lëvizjeve dhe grupeve të njerëzve që ngrënë zërin për barazi gjinore është rritur shumë kohëve të fundit.

Sipas mendimit tim, barazia gjinore nuk është as më shumë dhe as më pak se sa mundësi të barabarta dhe të drejta të barabarta dhe sundim i meritokracisë si për burrat, ashtu dhe për gratë.

## Ju jeni një nga të paktët burra që punoni drejtpërsëdrejti me barazinë gjinore në Kosovë. Si erdhi puna që të merreni me këtë temë?

Tema e "gjinisë" ka qenë gjithnjë pjesë e jetës time, që nga fëmijëria. Unë kam tri motra dhe teksa rritesha, kurrë nuk kam vërejtur ndonjë dallim ndërmjet nesh, edhe pse mua më kushtoj më shumë vëmendje si njëri prej djemve.

*Intervista u zhvillua nga Maïke Dafeld.*



*Puna për fushatën: Intervenimi "Reago njerëzishëm" promovon kurajon qytetare ndërmjet*

Kur në shkollë nisën të më ngacmojnë, në vend se të sillja një burrë që të më mbronte, ashtu si e kërkon tradita, unë solla motrat e mia. Motrat e mia ishin shoqet e mia më të ngushta dhe modelet e mia ndërsa rritesha. Sot kam tri mbesa dhe një nip dhe ata më frymëzojnë që të punoj për promovimin e barazisë gjinore. Në të kaluarën kam punuar në projekte që kishin të bënin me çështjet gjinore, por kryesisht të përqendruar tek gratë dhe vajzat. Sot, me shumë gëzim dhe kënaqësi unë punoj me burra dhe djem dhe kohëve të fundit edhe me baballarë apo burra që presin të bëhen baballarë. Për mua është e lehtë, sepse besoj në barazinë gjinore dhe ajo është pjesë përbërëse e jetës time. Unë e di sa e rëndësishme është të trajtohesh në mënyrë të barabartë, është një e drejtë themelore.

**Pse mendoni se është e rëndësishme të punoni sidomos me burra mbi temën e barazisë gjinore?**

Çështja e barazisë gjinore është perceptuar tradicionalisht si punë e grave. Mirëpo sipas statistikave, burrat janë shkaktarët kryesorë të pabarazisë gjinore, kryesisht për shkak të mënyrës si janë rritur në familjet e tyre dhe sjelljes që shoqëria

pret prej tyre në bazë të gjinisë së tyre. Normat e ngurta shoqërore që kanë formësuar mënyrën si sillen burrat me njëri-tjetrin dhe me gratë mbeten shqetësimi ynë kryesor. Diçka duhet të ndryshojë sa më parë që është e mundur për të sfiduar këto norma të ngurta të maskulinitetit. Kjo është arsyeja pse kemi konsideruar të punojmë me djemtë e rinj, që ta trajtojmë pabarazinë gjinore që në thelb. Nëse djemtë rriten në një mjedis ku prej tyre pritet të tregojnë dashuri, ndjenja dhe përkujdes dhe jo të tregohen të fortë, pa emocione, të pasjellshëm dhe të dhunshëm, mendoj se pikërisht atëherë është ndërmarrë hapi më i madh drejt shpërbërjes së normave sociale që përsërisin pa ndërprerë pabarazinë gjinore dhe drejt ndërtimit të një shoqërie të barabartë.

**Çfarë reagimesh morët nga burrat në Kosovë kur ua prezantuat këtë temë në fillim të projektit? Sa dinin ata në atë kohë për barazinë gjinore?**

Promovimi i barazisë gjinore me një qasje tek djemtë e rinj ishte diçka e re për shoqërinë kosovare. Kemi parë se ka patur nevojë për një projekt të tillë, pasi ka munguar për një kohë të gjatë. Nuk ishte e lehtë t'u qasesh djemve të rinj, të uleshe



*të rinjve.*

*Promovimi i klubit "Bonu burrë" në emisionin për*

me ta për të biseduar rreth gjinisë, dhunës gjinore dhe shëndetit dhe mirëqenies së tyre. Sa më shumë zgjaste projekti, aq më shumë ata donin të dinin. Gjatë adresimit të këtyre çështjeve të thjeshta, përgjigja më e shpeshtë ka qenë se askush nuk u ka folur më herët për këtë, a thua se gjinia nuk kishte të bënte me ta. Ndihma për djemtë e rinj që të kuptojnë rolin dhe përgjegjësitë e tyre krijoi më shumë interesim. Ata madje mësuan se sa shumë përfitojnë burrat dhe djemtë nga barazia gjinore. Mund të them me krenari se sot, shumë prej atyre djemve janë agjentë të ndryshimit.

Të rinjtë në Kosovë janë më mendjehapur nga sa mendojmë. Ne thjesht nuk ua kemi dhënë mundësinë deri tani që të jenë pjesë e programeve të tilla si Nisma e Djemve të Rinj.

**Si punoni me djemtë dhe burrat? Cilat janë masat konkrete që keni ndërmarre për të arritur qëllimet e projektit?**

Si nismë e re, vendosëm që të investojmë shumë tek hulumtimi për të matur ndikimin e projektit tonë, për të mësuar se çfarë funksionon dhe çfarë jo dhe çfarë duhet të ndryshojë. Kemi implementuar hulumtimin bazë dhe më pas vazhduam me implementimin e punëtorive nëpër shkolla dhe filluam fushatën “Bonu burrë”.

Për shkak të rezultateve të suksesshme gjatë viteve të projektit, arritëm që programin ta akreditojmë nga Ministria e Arsimit si pjesë e kurrikulumit të shkollave. Ky program ka qenë shumë i rëndësishëm dhe përpunet me kriteret e Ministrisë së Arsimit. Më e rëndësishmja është se ai plotëson zbrazëtitë në programet paraekzistuese. Ne filluam me trajnimin dhe përgatitjen e profesorëve dhe programin e zgjeruam në Kosovë dhe në rajon. Kjo ka qenë një nga sfidat e mia më të mëdha, pasi me vështirësi e kemi bindur Ministrinë e Arsimit

*gatime “Diçka po zihet” në RTV21. Në Ditën e të Drejtave të Njeriut: djem nga Klubi “Bonu Burrë” po gatuajnë në shëtitoren “Nëna Terezë” në Prishtinë nën parrullën “Kush thotë se djemtë s’dinë të gatuajnë?”*



se programe të tilla dhe akreditimi i tyre janë të nevojshme për shkollat tona.

**Në ç’mënyrë mendoni se gjinia luan rol për tematikën e ballafaqimit me të kaluarën?**

Aktualisht, kjo është një nga çështjet më të ndjeshme kur merremi me gjininë, sidomos në mentalitete si i Kosovës dhe pjesës tjetër të rajonit, që mbizotërohen nga shumë elementë patriarkalë.

Qëndrimet dhe sjelljet e brezit aktual të djemve në Kosovë dhe në Ballkan janë ndikuar nga fakti se kanë lindur gjatë ose menjëherë pas luftërave në Jugosllavi. Të rinjtë janë pjekur në kohëra të trazuar gjatë rindërtimit pas konfliktit. Ende janë të pranishme versione të militarizuara të maskulinitetit, sikurse dhe tensionet rreth identiteteve socio-kulturore dhe politike. Ky sfond më i gjerë luan rol themelor në formësimin e ideve të të rinjve për maskulinitetin.

Nisma e Djemve të Rinj përfshin djem të rinj që duan të ndryshojnë botën ku jetojnë. Ajo i sfidon ata të bëhen burra modernë që e shprehin maskulinitetin e tyre në mënyrë të shëndetshme.

Megjithatë, mbetet ende një sfidë e madhe që t’u shpjegosh disa nga idetë bazë të barazisë gjinore personave që janë rritur me norma të tilla të ngurta.

**Nisma e Djemve (ND)**

Djemtë dhe Burrat si Aleatë për Parandalimin e Dhunës dhe Transformimin Gjinor në Ballkanin Perëndimor ose Nisma e Djemve të Rinj (ND) synon të zhvillojë më tutje strategjitë vendore për të adresuar pabarazinë gjinore duke adresuar normat shoqërore dhe maskulinitetin e dëmshëm që ndikon tek djemtë dhe burrat në Serbi, Kosovë, Bosnje e Hercegovinë dhe Shqipëri. Qëllimi i projektit është të promovojë tek djemtë dhe burrat (si dhe vajzat dhe gratë) që marrin pjesë në program stile jetese të shëndetshme, jo të dhunshme dhe me barazi gjinore.

Më shumë informata mund të gjeni në: <http://www.youngmeninitiative.net/en/>



# Sillu si burrë!



***Vojslav Arsiq** është themeluesi i Centre E8 në Beograd. Ai beson në arsimin joformal dhe “të nxënit duke bërë”. Ai punon si trajner në disa lëmi dhe i pëlqen të përdorë më së shumti metodat teatrale në arsim. Ai është një nga krijuesit e programit “Bëhu burrë” përmes të cilit djemtë e rinj promovojnë barazinë gjinore dhe sjelljet jo të dhunshme duke krijuar imazhin e ri të “burrit nga Ballkani”.*

*Tema e barazisë gjinore shpeshherë perceptohet si "punë e grave" dhe ngatërrohet me feminizmin. Rolet e burrave rrallëherë vihen në pikëpyetje apo të rivlerësohen. Megjithatë, përfshirja e tyre në procese që çojnë drejt një shoqërie më të barabartë është me rëndësi kyçe.*

Ç'do të thotë të përdorësh "perspektivën gjinore" tek puna me djem të rinj? Gjinia – ndryshe nga seksi – ka të bëjë me mënyra të ndryshme, të kushtëzuara nga shoqëria se si gratë dhe burrat kanë mësuar të mendojnë dhe të sillen. Është mënyra në të cilën këto role, zakonisht role stereotipike, mësohen dhe përforcohen. Ndonjëherë supozojmë se mënyra se si sillen djemtë dhe burrat është "e natyrshme" dhe se "djemtë gjithnjë mbeten djem". Nuk është e lehtë të ndryshosh mënyrën se si i shohim dhe i rrisim djemtë. Megjithatë, kjo do të kishte potencialin për të transformuar marrëdhëniet gjinore dhe për të pakësuar sfidat e shumta me të cilat përballen gratë dhe burrat.

Hulumtimet kanë treguar se aftësia për të kuptuar dhe për të shprehur stresin emocional në mënyrë jo të dhunshme përbën faktor mbrojtës nga probleme të shumta me të cilat përballen djemtë e rinj gjatë zhvillimit të tyre. Kështu, të rinjtë janë të cënueshëm kur ndjehem të kufizuar në shprehjen e ndjenjave lidhur me rrethanat e pafavorshme apo ngjarjet stresuese në jetën e tyre.

Për vite të tëra, shoqëritë tona kanë supozuar se si ndjehen djemtë e rinj. Shpeshherë ne supozojmë se ata janë në rregull dhe se kanë më pak nevoja nga vajzat. Në disa rrethana të tjera supozojmë se janë të vështirë për të punuar me ta, janë agresivë dhe nuk e vrasin mendjen për jetën. Shpeshherë i shohim si kryerës të dhunës kundër djemve të tjerë apo grave pa u ndalur për të analizuar mënyrat se si shoqëria shpesh shpërfill dhunën që kryhet nga djemtë. Që ata të zhvillohen në mënyrë të shëndetshme, gjetjet dhe qasjet e reja kanë nevojë për një të

kuptuar më të kujdesshëm të nevojave të tyre dhe të mënyrës se si djemtë socializohen.

Ashtu sikurse me aspektet e tjera të jetës dhe shëndetit, normat gjinore kanë ndikim tek shëndeti emocional dhe mendor i të rinjve. Pritshmëritë sociale që promovojnë idenë se "burrat e vërtetë" duhet të jenë të "fortë" dhe "trima" mund të çojnë në situata ku djemtë fshehin frikën, trishtimin apo mirësinë dhe mund të çojnë në situata ku nuk kërkojnë për ndihmë edhe nëse kanë nevojë. Mohimi apo shtypja e tensioneve dhe problemeve, si dhe vështirësia për të diskutuar ndjenjat lidhur me to mund të çojnë në sjellje të dhunshme dhe vetë-shkatërruese.

Në Serbi, ashtu si në shumë shoqëri të tjera, shpesh ekziston një apo më shumë versione të maskulinitetit apo pritshmërive që konsiderohen të duhura apo dominuese se si duhet të sillen burrit; quhet hegjemonia e maskulinitetit. Kjo hegjemoni e maskulinitetit idealizohet, shndërrohet në mënyrë nënshtrimi dhe diskriminimi kundër burrave që janë ndryshe nga shumica. Duke analizuar rrethanat të ndryshme, shpesh shohim shumë ngjashmëri në përkufizimin e maskulinitetit me mënyrën se si burrat priten të sillen. Për shembull, shumë kultura mbështesin idenë se burri i vërtetë është kreu i familjes, është mbrojtësi i familjes dhe komunitetit të tij. Por ne kurrë nuk pyesim veten se si ndjehen burrat në këto role të përcaktuara. Djemtë shpeshherë rriten në atë mënyrë që të kenë shkathtësitë që nevojiten për rolin e mbrojtësit, të jenë agresivë dhe të prirur për konkurrencë. Ata po ashtu rriten në atë mënyrë që të besojnë në fuqinë e kodit të "nderit" që i detyron të konkurrojnë apo të përdorin dhunën për të dëshmuar burrërinë. Djemtë që interesohen për punë të shtëpisë, si gatimi, pastrimi apo kujdesi për motrat dhe vëllezërit më të vegjël dhe që i tregojnë hapur ndjenjat e tyre apo nuk kanë patur marrëdhënie seksuale shpeshherë i

nënshtrohen talljes dhe poshtërimit nga shokët apo familjarët se janë të dobët apo nuk janë burra të vërtetë.

Që nga momenti i lindjes, caktohen rolet shoqërore sipas ndryshimeve biologjike. Është shumë e vështirë të gesh një shitore me dhurata për fëmijë që të jenë neutrale në aspektin gjinor. Për vajzat, lodrat e tilla si kukullat, enët e kuzhinës, pajisjet për pastrim, mikrofonat janë gjithnjë në ngjyrë rozë. Nga ana tjetër, armët, makinat apo ushtarët për djemtë janë, sigurisht, të kaltër. Pra, edhe pse ende nuk jemi të vetëdijshëm se çfarë dhe kush jemi, ne e dimë cilat ngjyra do të përdorim dhe me cilat lodra të luajmë.

Duke u rritur, djemtë nuk fantazojnë që të ushtrojnë dhunë tek gratë apo shokët, ata shpesh ëndërrojnë për gjëra të mëdha, si të bëhen pilotë, mjekë apo të udhëtojnë nëpër botë. Pyeteni veten sa herë keni dëgjuar mesazhe të qarta se si duhet të silleni si burrë apo si grua teksa keni qenë duke u rritur. Gjinia është një konstrukt aq i rëndësishëm kulturor, saqë nuk ka nevojë të mësohet për të. Të gjitha mesazhet që na rrethojnë na tregojnë se si të sillemi dhe ne thjesht e përvetësojmë atë sjellje. Nga ana tjetër, askush nuk na mëson për gjininë dhe nuk kemi ndonjë filter për mesazhet që pranojmë.

Për të qenë në gjendje të punojmë me transformimin e maskulinitetit, së pari duhet të kuptojmë se kush janë djemtë sot, si janë bërë ashtu dhe kush është përgjegjës për këtë. Në atë çast do të kuptojmë se ne si shoqëri e kemi këtë përgjegjësi dhe për t'i kontribuar transformimit të nocionit të maskulinitetit, na duhet ta marrim përsipër këtë përgjegjësi. Barazia gjinore nuk është çështje biologjike, por një sërë njohurish që na çojnë drejt një shoqërie më të barabartë dhe më të drejtë. Për të punuar drejt kësaj shoqërie, burrat dhe djemtë duhet të përfshihen në proces. Nëse burrat janë pjesë e problemit, ata duhet të jenë edhe pjesë e zgjidhjes.

# Të mbijetuarat kërkojnë të drejtat e tyre!

*Me 2 dhjetor 2015, TRIAL organizoi në Sarajevë një tryezë të rrumbullakët për*

*ushtrimin e së drejtës për kompensim të viktimave të krimeve të luftës në procedurë penale.*

Ana B. e takova së pari në vitin 2012. Rashë në kontakt me të përmes kolegëve të mi nga një OJQ që merrej me të drejtat e grave. Menjëherë e kuptova se ishte një grua me temperament të butë, por edhe këmbëngulëse për të treguar se asaj i ishin mohuar të drejtat për më shumë se 20 vjet. Pavarësisht këmbënguljes së hapur që vinte si rezultat i drejtpërdrejtë i mbështetjes nga pjesëtarët e familjes, ajo kishte nevojë edhe për mbështetje profesionale. Pikërisht këtë i ofroi TRIAL.

Nga bisedat tona të mëvonshme, mora vesh se e kishin përdhunuar në moshë të mitur, në fillim të luftës në Bosnje e Hercegovinë, në qershor 1992. Ana B. gjeti kurajon për ta raportuar menjëherë krimin tek policia në Kotor Varosh. Ajo dhe familja e saj dhanë deklaratat dhe identifikuan qartë kryerësit. Mirëpo, Prokuroria e Qarkut asnjëherë nuk e inicoi procedurën penale. Kryerësit jetonin të lirë, të bindur se nuk do të përballeshin kurrë me drejtësinë apo të jepnin llogari për krimet që kishin kryer më shumë se njëzetë vjet më parë. Nga ana tjetër, Ana B. nuk ishte më e bindur se mund të shpresonte për ndonjë rezultat pozitiv pas kaq shumë kohësh. Pa ndonjë hetim dhe pa ndjekje penale të mirëfilltë për krimet e kryera kundër saj, pa ndonjë formë të reparacionit, ajo ishte vetëm një nga të mbijetuarat e shumta që kishin pushuar së besuari se drejtësia do të vihej në vend. TRIAL zhvilloi disa diskutime që u pasuan nga aktivitete të përbashkëta me institucionet gjyqësore përgjegjëse dhe mekanizma të tjerë shtetërorë; qëllimi kryesor ishte që të sigurohej qasje në drejtësi për Ana B. dhe asaj t'i jepej informacion i plotë për rastin e vet.

TRIAL ofroi këshillim ligjor dhe në bashkëpunim me organizata të tjera, edhe mbështetje psikologjike, si dhe avokoi në emër të saj, duke ushtruar presionin e nevojshëm tek institucionet e duhura gjyqësore që të ndërmerren veprime. Më në fund u ngrit aktakuza kundër dy personave, që u konfirmua dy vite më vonë. Pas këmbënguljes së pandërprerë të TRIAL për të avokuar për të drejtat e të mbijetuarve të krimeve të luftës, organizata

punësoi një avokat që të përfaqëonte Ana B. për të drejtën e saj në kompensim të përshtatshëm për traumën që kishte pësuar. Në fund të vitit 2014, Ana B. dëshmoi para gjykatës. Pas disa viteve në beteja ligjore, Gjykata e Bosnje e Hercegovinës më në fund i dënoi me vendim të shkallës së parë me nga 10 vjet burg të dy ushtarët e Ushtrisë së Republika Srpskas (URS) për krimin e luftës të përdhunimit të kryer kundër vajzës së mitur. Për të parën herë në historinë e procedurave penale në Bosnje e Hercegovinë, Gjykata ofroi kompensim për një viktimë të krimeve të luftës, duke i urdhëruar të akuzuarit që të paguanin në para kompensimin për palën e dëmtuar.

Më vonë, Ana B. ka shpjeguar me fjalët e saj se ç'domethënie pati për të që të punonte me TRIAL: "Beteja ime nuk do të kishte qenë e mundur pa përpjekjet dhe mbështetjen e TRIAL. Gjatë tërë kohës që kemi komunikuar, kam ndjerë një marrëdhënie thellësisht të sinqertë; atë lloj marrëdhënieje që mund të ndahet vetëm mes grave. Vendimi i Gjykatës së Bosnje e Hercegovinës do të thotë shumë për mua, sidomos ngaqë kisha humbur shpresën se kryerësit do të përballeshin ndonjëherë më drejtësinë. Beteja ime më tregoi se drejtësia arrihet dhe se krimet e luftës nuk i nënshtrohen parashkrimit".

Rasti i Ana B. dhe vendimi në rastin e saj janë pjesë e një sërë rastesh të rëndësishme që janë sjellë para institucioneve gjyqësore të Bosnje e Hercegovinës, ndërsa për të mbijetuarën dhe familjen e saj, është rasti më i rëndësishëm.



Pas shumë vite pritjeje, vendimi dhe kompensimi sollën një pikë të vogël kënaqësie për viktimat dhe familjet e tyre, që prej vitesh ishin në pritje të drejtësisë. Këmbëngulja për të luftuar dhe për të ushtruar të drejtat e tyre doli të jetë e duhura. Gjykimi dhe dënimi i kryerësve bëri të ditur se shteti e kishte pranuar detyrën e vet për të mbrojtur të drejtat dhe qytetarët e vet dhe se kishte filluar të përkujdesej për gratë që kanë humbur aq shumë gjatë luftës. Vendimi, gjatë verifikimit të fakteve, është një pranim formal dhe ligjor i vuajtjes që kanë përjetuar viktimat. Po ashtu, i sjell të mbijetuarat e dhunës gjinore dhe seksuale gjatë luftës edhe një hap më pranë kthimit të dinjitetit që u takon.

Përveç Ana B., në të njëjtën kohë u mor dhe një tjetër vendim i rëndësishëm, në rastin kundër Sllavko Saviqit. Ai u dënua nga Gjykata e Bosnje e Hercegovinës disa ditë para vendimit në rastin e Ana B. Që të dy këto raste janë të parat në historinë e Bosnje e Hercegovinës dhe më gjerë në rajon ku të mbijetuarat e përdhunimeve gjatë luftës dhe viktimat e krimeve të luftës kanë marrë kompensim si pjesë e procedurës penale për dëmin që u është shkaktuar. Pra, këto raste kanë domethënie edhe më të madhe, pasi i hapin rrugën drejtësisë për shumë viktime të tjera që ende janë në pritje të të drejtave të tyre.

Gjatë luftës në Bosnje e Hercegovinë (1992-1995), përdhunimi është përdorur si mjet për spastrim etnik dhe për të rritur urrejtjen ndëretnike. Një numër i konsiderueshëm i rasteve të dhunës seksuale dhe përdhunimeve janë ndjekur penalisht nga Tribunali i Hagës (ICTY) dhe nga gjykatat në Bosnje e Hercegovinë. Mirëpo, shumë individë që janë fajtorë për kryerjen e krimeve të tilla, ende nuk janë ndëshkuar.

Në Bosnje e Hercegovinë është arritur njëfarë progresi sa i përket ushtrimit të të drejtave të viktimave të luftës dhe të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës. Për sa kohë që të mbijetuarat dhe familjet e tyre nuk i ushtrojnë të drejtat e tyre të plota në të gjithë vendin, marginalizimi dhe diskriminimi i tyre do të vazhdojë. Shoqatat e viktimave dhe OJQ-të kanë bërë përpjekje për vite të tëra për numrin e madh të të mbijetuarave që kanë pritur të ushtrojnë të drejtat e tyre të garantuara për shumë vite. Që në Bosnje e Hercegovinë të arrihet pajtimi, hapi i parë që nevojitet është ushtrimi i të drejtave të viktimave të luftës.


*E themeluar në vitin 2002 në Gjenevë, organizata TRIAL ka si mandat vënie në punë të ligjit për viktimat e krimeve ndërkombëtare (gjenocid, krime kundër njerëzimit, krime lufte, torturë dhe zhdukje të dhunshme), luftën kundër mosndëshkimit të kryerësve të krimeve më të rënda ndërkombëtare. Organizata përfaqëson interesat e viktimave para gjykatave zvicerane dhe shumë organeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe punon për rritjen e vetëdijësisë të qeverisë dhe publikut lidhur me nevojën për një sistem gjyqësor vendor dhe ndërkombëtar më efikas për ndjekjen penale të krimeve. Në vitet e fundit, kjo organizatë ka ofruar asistencë ligjore për 360 viktime në 145 procedura ndërkombëtare për Algjerinë, Bosnje e Hercegovinën, Burundin, Libinë, Nepal, Rusinë dhe Tunizinë. Puna në Bosnje e Hercegovinë ka filluar në vitin 2007 në kuadër të ofrimit të mbështetjes për familjarët e personave të zhdukur dhe që nga viti 2010, organizata po ofron mbështetje edhe për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës. Aktivitetet e zyrës në Bosnje e Hercegovinë janë kryesisht ndihmë juridike falas për viktimat e krimeve të luftës para organeve vendore dhe ndërkombëtare dhe mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Përmes rasteve gjyqësore strategjike në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, organizata i kontribuon përmirësimit të gjendjes së përgjithshme të viktimave të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë dhe ushtron presion tek autoritetet për t'i bërë ata të respektojnë të drejtat e tyre të njeriut. TRIAL gjithashtu rrit vetëdijësimin e publikut dhe avokon për drejtësi duke ushtruar presion tek autoritetet kompetente për përfshirje aktive në gjetjen e zgjidhjeve për problemet me të cilat përballen të mbijetuarit.*



**Selma Korjeniq** u bë pjesë e TRIAL në gusht 2010 si Zyrtare për të Drejtat e Njeriut, përgjegjëse për Programin e Mbështetjes për të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale Gjatë Luftës dhe si Udhëheqëse e Programit në zyrën e TRIAL në Bosnje e Hercegovinë në nëntor 2014. Para se të bëhej pjesë e TRIAL, ajo ka punuar në Qendrën e Sarajevës për Hulumtime dhe Dokumentim si Menaxhere e Projekteve për çështje lidhur me shkaqet dhe pasojat e Luftës në Bosnje dhe Hercegovinë (1992-1995). Selma ka diplomuar për Sociologji nga Fakulteti për Shkenca i Sarajevës dhe aktualisht po përfundon masterin pranë të njëjtit universitet. Ajo është specialiste mekanizmave dhe procedurave të së drejtës ndërkombëtare të njeriut dhe e fushës së drejtësisë tranzicionale, si dhe ka punuar direkt me të mbijetuarat e luftës. Ajo punon në boshnjakisht/serbisht/kroatisht dhe anglisht.

# Zhdëmtim për të mbijetuarat e dhunës seksuale nga konflikti në Kosovë

*Është arritur progres i konsiderueshëm në ofrimin e qasje në drejtësi dhe zhdëmtimit për të mbijetuarat; po finalizohet një kornizë ligjore për reparacionet dhe tabuja e diskutimit të kësaj çështjeje dalëngadalë po zbutet falë nismave të ndryshme për rritjen e vetëdijësisimit. Megjithatë, ende mbetet sfida e adresimit të nevojave të shumëllojshme të të mbijetuarave.*



**D**huna seksuale ndërlidhur me konfliktin (DHSNK) shpesh është përvoja më e tmerrshme dhe më traumatike që një individ mund të përjetojë gjatë një konflikti. Dëmi dhe pasojat mund të përfshijnë trauma afatgjate fizike, mendore dhe emocionale, humbje të mundësive, shkelje të tjera të të drejtave të njeriut dhe dëm moral. Ndikimi shkatërrues fizik dhe psikologjik i dhunës seksuale shpesh vjen nga stigma që e shoqëron.

“Për mua ishte më e lehtë, pasi burri im është i arsimuar. Mirëpo në disa zona, është më e vështirë t’i ngrësh këto çështje. Ata nuk duan t’i dëgjojnë historitë e njerëzve të tjerë, e aq më pak të grave të tyre! Po ta dinin, nuk do t’i lejonin të punojnë... do t’i mbyllnin në shtëpi pa asnjë mbështetje” ka thënë një e

mbijetuar nga Kosova.

Në Kosovë, si në shumë vende të tjera, ka qenë shumë e vështirë të flitet për dhunën seksuale të ndërlidhur me konfliktin. Të mbijetuarat kanë censuruar vetveten, ose janë censuruar nga të tjerët, nga frika se mos turpërojnë veten dhe familjet.

“Ne duhet t’i edukojmë [njerëzit] se për gratë, lufta nuk solli lule, por vuajtje. Dhe se i njëjti fat mund t’u kishte rënë për hise grave apo nënave të tyre. Është shumë e vështirë, sepse po cënove nderin e një gruaje shqiptare dhe nëse një kriminel e abuzon seksualisht atë, ai ka prekur nderin e familjes. Dhe një burrë nuk duhet t’i pranojë haptazi këto gjëra” ka thënë një e mbijetuar shqiptare etnike.

Pas konfliktit, disa organizata kanë ofruar në heshtje shërbime për të mbijetuarat e DHSNK. Të mbijetuarat nga grupe të ndryshme etnike, kryesisht gra, por edhe disa burra, kanë marrë shërbime shëndetësore mendore dhe fizike emergjente.

Shoqëria civile ka organizuar diskutime publike për të pranuar dhe dokumentuar përvojat dhe nevojat e të mbijetuarave deri në vitin 2003. Nga viti 2012, këto përpjekje u shtuan. Sot, pak çështje të tjera, për të mos thënë asnjë, kanë marrë të njëjtën vëmendje për pranim dhe mbështetje. Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Ministritë, Kuvendi, partitë politike, shoqëria

civile dhe mbështetësit ndërkombëtarë kanë deklaruar mbështetjen e tyre për mbrojtjen e të drejtave të të mbijetuarave të DHSNK. Në mars 2014 u themelua Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, nga Presidentja e atëhershme, Atifete Jahjaga. Ky Këshill shërbeu për të koordinuar reagimet, për të theksuar dhe adresuar nevojat dhe të drejtat e të mbijetuarave të DHSNK. UN Women ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë këto procese.

Sipas së drejtës ndërkombëtare, viktimat e DHSNK kanë të drejtë për zhdëmtim dhe reparacion. Këtu përfshihet qasje e barabartë dhe efektive në drejtësi, reparacione adekuate, efektive dhe të menjëhershme për dëmin e shkaktuar dhe qasje në informata që kanë të bëjnë me shkeljen dhe mekanizmat e reparacionit.

Janë ndërmarrë hapa për të siguruar qasje në drejtësi. Meqë kompetencat për ndjekje penale janë bartur nga Misioni për Sundimin e Ligjit të Zyrës së BE-së tek autoritetet e Kosovës, theksi është vendosur tek fasilitimi i hetimeve dhe ndjekjes penale të DHSNK. Në mesin e shumë arritjeve, Këshilli dhe anëtarët e tij kanë krijuar një plan për qasje në drejtësi për viktimat e DHSNK që po implementohet nga Ministria e Drejtësisë dhe partnerët e saj.

Amendimi në mars 2014 i ligjit themelor që siguron benefitet për veteranët dhe viktimat civile i dha shtysë një kornizë ligjore për



krijimin e reparacioneve për të mbijetuarat e DHSNK. Në shkurt 2016 u miratua një rregullorë për implementimin dhe krijimin e një Komisioni të pavarur për verifikimin e statusit të të mbijetuarave të DHSNK duke mundësuar qasje në benefite individuale. Zyra e Kryeministrit udhëheq krijimin në praktikë të Komisionit, është përzgjedhur Sekretariati dhe janë ndërmarrë hapa për të funksionalizuar Komisionin.

Korniza ligjore aktuale që do të implementojë Komisioni është një hap i madh në drejtimin e duhur për të njohjen e të drejtës së të mbijetuarave të DHSNK për zhdëmtim dhe reparacion. Megjithatë, ende duhet marrë parasysh shkalla e gjerë e nevojave të të mbijetuarave të DHSNK. Për shembull, sipas ligjit, të mbijetuarat e DHSNK (dhe familjet e tyre) nuk kanë qasje në sistemin e kujdesit shëndetësor në Kosovë apo në mundësi për arsim dhe aftësim, që janë me rëndësi të madhe për transformimin e jetëve të tyre. Këshilli ka kërkuar që të plotësohen benefitet sipas kornizës ligjore për të mbijetuarat e DHSNK. Presidentja Jahjaga ka nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit me Ministrinë e Shëndetësisë për t'u mundësuar të mbijetuarave qasje në sigurim shëndetësor dhe për t'u siguruar mbështetje ofruesve të shërbimeve që punojnë me të mbijetuarat; po ashtu, Këshilli ka pilotuar një program për fuqizimin ekonomik

të të mbijetuarave në bashkëpunim me Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Presidentja dhe anëtarët e Këshillit kanë përqendruar edhe shumë nisma për të thyer heshtjen që ka rrethuar deri vonë të mbijetuarat e DHSNK në Kosovë, një sfidë kjo që korniza ligjore ende nuk është në gjendje të adresojë.

UN Women ka punuar me të mbijetuarat e DHSNK në Kosovë për t'i dëgjuar dhe për t'u dhënë hapësirë zërave të tyre që të zhvillojnë përpjekje të mëtejshme të fokusuara për reparacion. Këto zëra janë në fokus të raportit që do të publikohet së shpejti nga UN Women. Edhe pse të gjitha të mbijetuarat kanë të drejtë për zhdëmtim dhe reparacion, këto nevoja nuk janë uniforme. Edhe pse qasja në kujdes shëndetësor dhe mjete financiare janë prioriteti kryesor për shumë prej tyre, të vejat, nënat vetëushqyese dhe ato që janë martuar me persona të plagosur gjatë luftës apo me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi shtesë. Të mbijetuarat me fëmijë përqendrohen kryesisht tek mundësia e tyre për t'i ushqyer dhe arsimuar fëmijët, me shpresën që t'u sigurojnë një jetë më të mirë. Të mbijetuarat duan një kërkimfalje zyrtar dhe që Kuvendi t'u njohë vuajtjet dhe të drejtat. Raporti po ashtu paraqet hapat e rëndësishëm që janë ndërmarrë në Kosovë për të mbështetur të drejtat e të mbijetuarave për zhdëmtim dhe reparacion, si dhe propozon masa që mund të plotësojnë ato përpjekje në mënyrë që t'u jepet përgjigje

nevojave të ndryshme të të mbijetuarave dhe që reparacionet të jenë sa më transformativë dhe gjithëpërfshirëse që është e mundur. Një rekomandim kyç në raport ka të bëjë me pjesëmarrjen e mirëfilltë të të mbijetuarave në dizajnimin dhe vendimmarrjen e të gjitha proceseve që kanë të bëjnë me to.

*Në mbarë botën, UN Women mbështet shtetet që të përmbushin detyrimet e tyre për të siguruar të drejtën për zhdëmtim dhe reparacion për të mbijetuarat e DHSNK. Në Kosovë, UN Women ka ndihmuar me zhvillimin e një plani të veprimit për implementimin e UNSCR 1325, një prej objektivave të të cilit është ofrimi i zhdëmtimit për të mbijetuarat e DHSNK. Po ashtu, UN Women ka mbështetur edhe zhvillimin dhe amendimet e kornizës ligjore që të njohë të mbijetuarat e DHSNK, ka mbështetur këshillin dhe ofruesit e shërbimeve që punojnë me të mbijetuarat dhe aktualisht po mbështet procesin e themelimit të Komisionit për verifikimin e të mbijetuarave.*



**Siobhan Hobbs** Siobhan Hobbs është Specialiste e Drejtësisë Gjinore pranë UN Women dhe autore e raportit mbi dizajnimin e një programi reparacioni për të mbijetuarat e DHSNK në Kosovë që pritet të dalë së shpejti.

**Nita Gojani** është Menaxhere e Projektit të drejtësisë tranzicionale gjinore nga UN Women dhe BE-ja në Kosovë.

# Paqja e

L

*Gratë rrallëherë përfshihen në proceset e paqes pas luftës dhe lihen anash kur fillon rindërtimi i shoqërive. Lidhja Ndërkombëtare e Grave për Paqe dhe Liri ka vendosur të sjellë ndryshime.*

Gjatë konflikteve, dhuna me bazë gjinore është e përhapur dhe gratë vuajnë së tepërmi. Sidoqoftë, përvoja e grave me dhunën dhe me dhunën me bazë gjinore, si dhe pjesëmarrja aktive e tyre në paqebërje dhe ndërtim të paqes nuk përjashtojnë njëra-tjetrën.

Për fat të keq, përfshirja e grave në faza të ndryshme të ndërtimit të paqes priret të reduktohet vetëm në përvojat e tyre si viktimat, ndërsa pjesëmarrja e tyre aktive në paqebërje shpërfillet. Kjo dikotomi ndërmjet të kuptuarit të grave si viktimat dhe grave si agjente të ndryshimit pasqyrohet më tej në negociatat formale për paqe, ku hapësira për pjesëmarrje të mirëfilltë të grave është shumë e kufizuar, por edhe gjatë periudhave pas konfliktit, kur gratë shpeshherë kufizohen të punojnë brenda lëmvive që konsiderohen më pak të ndjeshme politikisht apo që 'tradicionalisht' janë punë të grave.

Që nga viti 2013 Lidhja Ndërkombëtare e Grave për Paqe dhe Liri (LNGPL) po udhëheq një nismë që fokusohet tek rëndësia e marrjes në konsideratë të përvojave dhe njohurive empirike të grave që kanë kaluar nëpër konflikte të armatosura dhe kanë luftuar për të drejtat e grave. Kjo nismë kombinon punën e LNGPL-së në fushat e të drejtave të njeriut dhe grave, paqes dhe sigurisë, në përpjekje për të ndryshuar narrativën dominuese të grave si viktimat. Kjo nismë është një bashkëpunim ndërkombëtar që ka nisur si bashkëpunim ndërmjet aktiviteve për të drejta të grave nga Bosnja e Hercegovina (BeH) dhe Siria dhe prandaj është quajtur Gratë Organizohen për Ndryshim në Siri dhe BeH. Që atëherë, ajo është rritur për të përfshirë aktiviste nga vende të tjera, në përpjekje për të nxitur dhe përfutur nga përvojat e grave nga konflikte të ndryshme dhe për t'u fuqizuar vetë për të zhvilluar strategjitë tona që të kërkojmë dhe të kemi qasje në drejtësinë sociale.

## pabarabartë

### Shtytja për pjesëmarrjen e grave

Ndërsa revolucioni sirian u shndërrua në luftë dhe komuniteti ndërkombëtar dhe palët ndërluftuese siriane filluan të takohen për negociatat për paqe, u bë gjithnjë e më e dukshme se gratë e Sirisë nuk do të përfaqësoheshin në bisedimet për paqe, pavarësisht Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara dhe të mësimëve të shumta nga konflikte të tjera se çfarë ndodh kur gratë lihen anash. Shumë prej këtyre mësimëve i kemi nxjerrë (dhe ende po i nxjerrim) nga shembulli i Bosnjes. BeH është një shembull me rëndësi se sa lehtë është t'ua heqësh grave hapësirën politike, ekonomike dhe angazhimin social dhe sa shpejt mund të ndodhë shtytja për rikthimin e pozitës së grave në shoqëri. Kur gratë kërkojnë qasje në drejtësi apo të drejta ekonomike dhe sociale gjatë dhe menjëherë pas luftës, ose barazi de facto, atyre u është thënë shumë shpesh nga komuniteti ndërkombëtar dhe nga elitat politike vendore se "ende nuk është koha, është shumë herët". Mirëpo tani e shohim se hapësira për angazhim politik dhe pozita politike duhet të merret menjëherë, edhe gjatë luftës vetë, në mënyrë që të ruhet hapësira dhe pjesëmarrja pas konfliktit.

Një nga hapësirat më të rëndësishme që duhet të kërkohet është pranë tryezës së negociatave. Kur elita politike, elita politike mashkullore negocion për paqe, ata nuk negociojnë vetëm për armëpushim, por edhe për vizionin e shoqërisë së pasluftës. Qasja për



krijimin e atij vizioni që ndërmerret nga akterët kryesorë gjatë negociatave për paqe (OKB, sistemet rajonale dhe shumica e ndërmjetësuesve) bazohet në një të kuptuar të ngushtë të grupeve të armatosura që janë edhe problemi, edhe një pjesë e zgjidhjes, duke i bërë ata të vetmen palë “legjitime” për të negociuar paqen, duke përjashtuar kështu grupet që kanë investuar më së shumti në paqe. Kjo gjë është e dukshme nga niveli i pjesëmarrjes së grave dhe shoqërisë civile në proceset më të fundit të paqes dhe tranzicionit në Siri dhe Libi, por mund të shihet edhe nëse hedhim sytë tek negociatat për paqe që u zhvilluan 20 vjet më parë në BeH. Në BeH ishin gratë ato që udhëhoqën proceset e vështira të ngritjes së rish në këmbë të shoqërisë. Ishin gratë që këmbëngulën për të drejtën e tyre të dinë se ku gjendeshin të zhdukurit, ato ishin të parat që kapërcyen kufijtë tek komunitetet e tjera dhe filluan dialogun, ato ishin të parat që u kthyen, ato kërkuan ndjekjen penale të kriminelëve të luftës dhe dhanë dëshmi për dhunën seksuale gjatë luftës në mënyrë që kryerësit të ndiqeshin penalisht. Por kur erdhi koha për t’i përcjellë këto përvoja praktike në ligje në politika, në amendamente kushtetuese etj., gratë nuk u ftuan në tryezë.

### **Dialogu i solidaritetit feminist nëpër linja dhe kufij të konfliktit**

Lidhja Ndërkombëtare e Grave për Paqe dhe Liri, bashkë me partneret e veta dhe gratë aktiviste nga BeH, që nga qershori 2013 është marrë me analizimin e proceseve që janë zhvilluar në BeH dhe ka përdorur strategji dhe të suksesshme, dhe më pak të suksesshme të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave të grave në përpjekjet e tyre për të tejkaluar sistemin me të meta që u krijua nga Marrëveshja për Paqe e Dejtonit.

LNGPL-ja mblodhi rreth 40 gra nga BeH që ishin aktive në kohë dhe segmente të ndryshme gjatë 20 viteve të fundit. Ne i thirrëm ato të ulen bashkë dhe të diskutojnë se çfarë kanë bërë, si e kanë bërë dhe cilat kanë qenë rezultatet. Në këto takime, u morëm me qasjen në drejtësi, negociatat për paqe, drejtësinë tranzicionale dhe dhunën seksuale në konflikte, të drejtat ekonomike dhe sociale, procesin e kthimit dhe dhunën kundër grave në BeH të pas luftës.

Paralelisht me gratë nga BeH që takoheshin në grupet e tyre sipas tematikës, LNGPL-ja organizoi dhe punëtori me organizata të grave nga Siria që të fillonin me diskutimet se si duhet

të duket paqja në Siri, duke ushqyer herë pas here diskutimet e tyre me disa nga gjetje e hershme nga takimet e grave të Bosnjes. Ne arritëm të sigurojmë një hapësirë ku këto përvoja të caktuara nga BeH të mund të ndërvepronin me përvojën e Sirisë, që ato të mësonin dhe të nxirrnin mësim nga njëra-tjetra, por edhe që këto përvoja të ndryshme t’i bashkonin në një pasqyrë koherente se si duhet aktivizimi i grave në situata konflikti dhe pas-konflikti dhe të hapësirave të ndryshme që duhet të krijohen për pjesëmarrjen e tyre.

Për këtë qëllim, në shkurt 2014 ne organizuam një konferencë të solidaritetit feminist, e para e llojit të vet. Rezultati i kësaj konference ishte një vend i mrekullueshëm nga t’ia nisnim, mirëpo ende ka shumë për t’u bërë në të ardhmen për të kapitalizuar vrullin e asaj pune që u krijua në ato katër ditë. Lidhjet dhe fuqizimi që u krijuan gjatë diskutimeve dhe vetë-reflektimeve gjatë të gjithë procesit, konfirmuan rëndësinë e shfrytëzimit të njohurive empirike të grave dhe përvojave të tyre ekzistuese për të krijuar një front të fuqishëm ndërkombëtar feminist për paqe.

Më shumë informacion për konferencën, raportin nga konferenca si dhe informata për aktivitete të tjera të nismës Gratë Organizohen për Ndryshim mund t’i gjeni në:

BKS: <http://womenorganizingforchange.org>

ANG: <http://womenorganizingforchange.org/en/>

**Nela Porobic** është Koordinatorja e Projektit për nismën Gratë Organizohen për Ndryshim në Siri dhe në Bosnje e Hercegovinë. Ajo ka qenë me Lidhjen Ndërkombëtare të Grave për Paqe dhe Liri që nga viti 2013. Sfera kryesore e punës së saj janë gratë, paqja dhe siguria, me fokus tek dhuna seksuale e ndërlidhur me konfliktin dhe drejtësia tranzicionale.



**Bukurie Mustafa** punon pranë Institutit për Trashëgiminë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve në Maqedoni që nga viti 2008. Në vitin 2014, Këshilli Shkencor i Institutit e nderoi me titullin e Bashkëpunëtores së Lartë për Hulumtime. Ajo vazhdon të merret me tema të gjuhës dhe etnologjisë dhe në të njëjtën kohë udhëheq projekte që forcojnë trashëgiminë kulturore të shqiptarëve etnikë në Maqedoni

# Le të (mos) flasim për seksin: reflektime rreth tabuve gjinore në gjuhën shqipe

●

**Sh**oqëria shqiptare, ashtu si shoqëri të tjera tradicionale ballkanase, është ndërtuar mbi parime morale të përcaktuara nga kolektivi.

Individi, si pjesëtar i kolektivit, sillet sipas këtyre parimeve. Këto parime janë të zbatueshme në funksionimin e një familjeje, e cila konsiderohet si qeliza bazë e shoqërisë, ku raportet e anëtarëve brenda saj janë të definuara qartë, duke përcaktuar rolet dhe marrëdhëniet në mes burrit, gruas dhe fëmijëve. Në raporte të tilla, roli i amvisës dhe edukatores tradicionalisht i takon gruas. Janë gratë ato që

duhet të kujdesen t'i mësojnë fëmijët sipas vlerave të edukimit familjar. Mirëpo, me rritjen e fëmijëve, këto role ndryshojnë. Babai merret me djemtë, ndërsa nëna merret me vajzat. Ajo i përgatit vajzat për t'u martuar dhe bart tek ato këto vlera familjare. Parimi kryesor i kësaj sjelljeje mbështetet tek vlerat morale tradicionale të të nxëniet të gjërave si: “e ndaluar”, “e turpshme”, “e moralshme”, “e pamoralshme”, “mëkat” etj. Këto janë vlerat e të ashtuquajturit mentalitet ballkanas. Sistemi i bazuar në vlerat morale të tilla ka krijuar tabu, për të cilat nuk flitet as në familje e as në shoqëri. Ato kanë kushtëzuar edhe krijimin e një të folure të veçantë, ku gjërat nuk thuhet me emrin e tyre, por përdoren emërtime të “koduara” që ngërthejnë kuptime figurative lidhur me çështje intime.

Tema e intimitetit mes burrit e gruas është tabu kolektive dhe si e tillë flitet vetëm brenda llojit të vet. Prej këndeje dalin edhe shprehjet “muhabet burrash” e “llafe grash”. Kështu, edhe shprehja: “krejt muhabeti bohet rreth uçkurit”, është sinonim i lidhëses të brekëve a dimive dhe seksit dhe dëgjohet

shpesh në bisedat e burrave, por edhe të grave. Krahasimet gjuhësore zakonisht formohen nga gjëra a veprime nga jeta e përditshme dhe që lidhen drejtpërdrejt me punën e tyre, duke e marrë parasysh edhe ndarjen e punëve në mes gruas e burrit.

Tabutë e kësaj sfere i përfshijnë gratë, të cilat në komunikimin e tyre i përzgjedhin mënyrat e format, të cilat shndërrohen në kode e terminologji karakteristike për një të folme, që shpesh e dallojnë si gjuhë e grave. Kjo e folur e ndërthurur me parime morale të një kulture tradicionale, kryesisht është jo e drejtpërdrejtë dhe figurative me vetëdijen për vendin dhe rolin që ajo ka. Në rrethana të tilla, ajo natyrshëm krijon një fjalor të koduar për gjëra, të cilat në shoqëri llogariten si “të turpshme” dhe gjen mënyrat nga më të ndryshme për t’i komunikuar ato. Eufemizmat dhe metaforat shndërrohen në mjete shprehëse gjuhësore për të folur për tema të caktuara, si intimiteti, duke krijuar një fjalor të gjuhës popullore që buron nga tradita. Edhe dimensionet etno-kulturor është relevant. Shprehje si: “Ajo i ka bo punët herët n’sabah”; “I paska bo punët pi n’saba”; apo “Sonte kan kris kusitë”, aludojnë në një mbrëmje intime me burrin. Aludimet për kontakte seksuale mund të paraqiten edhe në formë pyetjesh: “A jeni la?” ose “A i keni tollovit çarshafat?” etj.

Edhe komunikimi te burrat, kur diskutohen çështje intimiteti, nuk ndryshon. Të shprehura përmes emërtimeve dhe shprehjeve të veçanta figurative të njohura vetëm për ata, ata sërish i referohen “punës” kur bisedojnë për çështje intime: “Ka mbet ara pa lëvru”, “Për të lëruar bahçen/arën duhet me t’punu pllugi”; “A e ke vadit bahçen”. Mund të dëgjoni dhe ndonjë mënyrë më të zbukuruar të të shprehurit: “A keni ba lule për me çel lule”. Kjo “me çel lule” nënkupton ngjizjen e një fëmije.

Bëhet e qartë nga lloje të ndryshme të të folurës se gjuha është e lidhur me botëkuptimin kulturor dhe kolektiv. Kështu, një hoxhë që flet me xhematin për jetën bashkëshortore do të përdorte terma nga e folura popullore për të shmangur emërtime të drejtpërdrejta për marrëdhëniet intime. Nga ana tjetër, një arsimtar i biologjisë, do të ligjëronte para nxënësve duke përdorur terma mjekësorë latinë. Për fat të keq, mentaliteti kolektiv shqiptar nuk ofron me të vërtetë opzione të tjera për ta adresuar këtë temë në mënyrë më pak të ngarkuar moralisht.

Sot nuk mund të flitet për një përplasje mes tradicionales dhe modernes në shoqëritë dhe familjet shqiptare. Transformimi dhe ndryshimi nuk është i plotë dhe nuk përfundon asnjëherë. Në fakt, ndryshimi gradualisht mban gjallë hendekun e lidhjes mes të kaluarës dhe bashkëkohores.





# lajme dhe përditësime

## Në dispozicion: Diskutime feministe - historia, kujtesa dhe ndryshimet

forumZFD Kosovë, Alter Habitus – Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë dhe Programi i Universitetit për Studime dhe Hulumtime Gjinore dhe Universiteti i Prishtinës publikojnë transkriptin e panelit një-ditor “Diskutime feministe: historia, kujtesa dhe ndryshimet” që u mbajt me 27 shkurt 2016.

Në panel merrnin pjesë aktiviste të shquara feministe nga Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Serbia dhe Kosova. Ato ndanë bashkërisht përvojat e tyre me organizimin dhe mobilizimin e rezistencës kundër luftës dhe politikave të dhunshme nacionaliste, si dhe risollën në kujtesë intervenimet dhe veprimet publike para, gjatë dhe pas viteve 1990. Veprimet e grave kanë përfshirë bashkëpunimin përtej ndarjeve dhe kufijve etnikë. Ky aktivizëm publik, i arritur përmes bashkëpunimit, solidaritetit dhe motërzimit, si dhe përmes diskutimeve, ka nxitur zhvillimin e lëvizjes feministe në rajon. Kjo lëvizje ka vënë në qendër gratë si agjente të ndryshimit, politikës dhe pushtetit.

Transkripti vë në dukje përvojat gjatë përpjekjeve dhe rezistencës, përpjekjet për ndërtim të paqes dhe mënyrat se si mobilizimi i grave gjatë kohës së luftës ka ndikuar në transformimin e shoqërive. Publikimi synon të sjellë para publikut përvojat e aktivisteve në vijën e parë të frontit në vitet 1990.

Paneliste ishin: Igo Rugova, Sevdije Ahmeti, Lepa Mladjenović, Shukrije Gashi, Stasha Zajović, Nazlije Bala, Nela Pamuković dhe Dasha Duhashëk. Panelin e moderuan Linda Gusia, Nita Luci dhe Vjollca Krasniqi. Në panel u nxitën mjaft mendime dhe diskutimet ishin shumë emocionale.

‘Diskutime feministe – historia, kujtesa dhe ndryshimet’ ishte atelieja e pestë në kuadër të projektit Harta e Kujtesës së Kosovës, që eksploron vende zyrtare, por të kontestuara të kujtesës dhe ngjarje të së kaluarës. Harta e Kujtesës së Kosovës synon të sjellë një perspektive të shumëanshme të re për të kuptuar kujtesën dhe procesin e kujtesës në Kosovë.

Transkripti mund të lexohet në uebfaqen [www.dwp-balkan.org](http://www.dwp-balkan.org). Për më shumë pyetje ose komente ju lutemi të kontaktoni me Korab Krasniqin ([krasnici@forumzfd.de](mailto:krasnici@forumzfd.de)) ose Linda Gusinë ([lindagusia@gmail.com](mailto:lindagusia@gmail.com)).

# numri i ardhshëm

Numri i 6-të i Balkan.Perspectives do të shqyrtojë nacionalizmin dhe etnocentrizmin në Ballkanin Perëndimor. Esetë do të analizojnë: (1) Si nacionalizmi dhe etnocentrizmi i kontribuojnë rishikimit të së kaluarës; (2) Si përhapen ata në shoqëritë tonë; dhe (3) Çfarë lloj mekanizmesh mund t'i parandalojnë.

# Impressum

*Balkan.Perspectives* publikohet nga *forumZFD*.

Forumi i Shërbimit Civil Paqësor (*forumZFD* - Forum Ziviler Friedensdienst), është organizatë gjermane e themeluar në vitin 1996. Kjo organizatë trajnon dhe angazhon ekspertë të paqes në rajonet e konfliktit që të bashkëpunojnë me akterët vendorë për të promovuar zgjidhje paqësore të konflikteve dhe bashkëjetesë paqësore. Partneri strategjik për Ballkanin Perëndimor është Pax Christi në Dioqezën e Aachen.

Në Ballkanin Perëndimor, fokusi është tek projektet e ballafaqimit me të kaluarën dhe për zhvillim të dialogut në mes të grupeve kundërshtarë. Këtu përfshihen projektet e ndërmjetësimit, mbështetja e shoqërisë civile ose zhvillimi i kapacitetit të medias për një qasje më konstruktive ndaj ballafaqimit me të kaluarën.

Programi financohet nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik e Gjermanisë (BMZ)

## KRYEREDAKTORE:

*Maïke Dafeld*

## EKIPI REDAKTUES:

*Sunita Dautbegoviq-Boshnjakoviq, Vjollca Islami Hajrullahu, Nora Maliqi, Johannes Rueger, Nehari Sharri*

## AUTORË:

*Vojislav Arsiq, Marina Blagojeviq, Nita Gojani, Siobhan Hobbs, Selma Korjeniq, Dr. Bukurie Mustafa, Nela Porobiq Isakoviq*

## FAQOSJA:

*Kokrra*

## SHTYPI:

*Envinion*

## PËRKTHIMI:

*LBG Communications (shqip), Bjanka Osmanoviq (BKS), Reis Kjerim (maqedonisht)*

## KORREKTURA GJUHËSORE:

*LBG Communications (shqip), Silvana Krzovska (maqedonisht), Zinaida Lakiq (BKS), Tenzin Dolker (anglisht)*

## KONTAKTI:

*Balkan.perspectives@forumzfd.de*

## VENDI I PUBLIKIMIT:

*Köln*

Forumi i Shërbimit Civil Paqësor | Forum Ziviler Friedensdienst e. V. (forumZFD)

Zyra në Kosovë: Sejdi Kryeziu 16 - Pejton 10000 Prishtina	Zyra në Serbi: Prote Mateje 17 11000 Beograd
Zyra në Bosnje e Hercegovinë: Rr. Branilaca Sarajeva 19 B 71000 Sarajevë	Zyra në Maqedoni: Rr. Borka Taleski 11/4 1000 Shkup

## Mohim i përgjegjësisë

*Balkan.Perspectives* është krijuar si një platformë rajonale për debate konstruktive mbi ballafaqimin me të kaluarën. Pikëpamjet e paraqitura në këtë revistë janë ato të kontribuesve dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e redaktorit apo të *forumZFD*-së dhe partnerëve të tij. Botuesit i kanë kontrolluar me kujdes lidhjet e internetit të promovuara në këtë revistë, por ata nuk mund të mbahen përgjegjës për përmbajtjen e faqeve të jashtme të internetit.

Kopjimi dhe rishpërndarja e këtij materiali, qoftë në formë të shtypur apo elektronike është i pranueshëm, por vetëm nëse teksti nuk ndryshohet dhe nëse përfshihen citimet e duhura. Për këtë nuk kërkohet pagesë.